



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë __ / __ / 2025

PËR

MIRATIMIN E KALIMIT NË ADMINISTRIM TË VARREZAVE, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE RRASHBULL, SUKTH, KATUNDI I RI, MANËZ DHE ISHËM, TEK NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr. 510, datë 10.6.2015, "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM-së nr. VKM-ja nr. 295, datë 2.5.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të ish komunës Ishëm, VKM-së nr.538, datë 7.8.2012 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut Durrës", VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës", VKM-së nr. 431, datë 15.05.2013, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Katundi i Ri, të Qarkut të Durrësit", VKM-ja nr. 1003, datë 10.12.2010 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Ligjore, kryetari i bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e kalimit në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës të varrezave dhe shërbimin funeral për fshatrat e njësive administrative të Bashkisë Durrës, sipas listës së përcaktuar në Aneksin nr. 1, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të Këshillit Bashkiak.


Ngarkimin e Njësive Administrative përkatëse, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Sektorin e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve që, brenda një afati prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të dorëzojnë pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale dokumentacionin, inventarët dhe çdo të dhënë lidhur me varrezat e territorit të tyre.

4. Ngarkimin e Drejtorisë së Financave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës që bazuar në ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, për pasqyrimin në kontabilitet të vlerës së pasurisë dhe kalimin e saj në inventarin ekonomik sipas legjislacionit financiar të varrezave të pasqyruara në Aneksin 1.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.


DREJTORIA LIGJORE

Alneida Broshi



DREJTORIA SHËRBIMEVE

Ardian Hjazaj



KRYETAR

Emiriana Sako



**Lista e varrezave që kalohen në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale
Durrës**

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Ishëm	Ishëm				
2	Ishëm	Likmetaj	185	2453		
3	Ishëm	Kërtushaj	304-169-24/5- 230, 26-68-87	2147		
4	Ishëm	Kapidanaj	46-68-87	2078		
5	Ishëm	Gjuricaj	140	1771		
6	Ishëm	Lalëz	49-108-247	2375		
7	Ishëm	Kuraten	126	2332		
8	Ishëm	Bizë	178-193	1204		
9	Ishëm	Draç	102-86-115- 129/3	1522		
10	Ishëm	Shetaj	200-234	3365		

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Rrashbull	Rrashbull	83/3, 108, 118/1, 188	3215		
2	Rrashbull	Arapaj	59/2, 308, 59/1, 103, 104/1, 118/ 1	1031		
3	Rrashbull	Shenvlash	192	3339		
4	Rrashbull	Shkallnur	165/6, 166, 167, 162/30	3385		
5	Rrashbull	Maskuri	91	2591		
6	Rrashbull	Bozaxhie	334/2, 794, 546/7	1256		
7	Rrashbull	Romanat	238/1, 238/2, 54/2, 163, 159/3, 318/13, 318/14	3236		
8	Rrashbull	Xhafzotaj	166, 167	2574		

BASHKIA Durrës

RELACION SHPJEGUES

PËR

MIRATIMIN E KALIMIT NË ADMINISTRIM TË VARREZAVE, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE RRASHBULL, SUKTH, KATUNDI I RI, MANËZ DHE ISHËM, TEK NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Para këshillit bashkiak

Këtu

Varrezat janë vendi më i ndjeshëm dhe më i shenjtë për çdo komunitet. Ato nuk janë thjesht pasuri publike, por hapësira që mbartin kujtesën dhe respektin për të afërmit tanë që nuk jetojnë më. Mirëmbajtja dhe administrimi i tyre nuk është vetëm një detyrim ligjor i bashkisë, por edhe një akt moral dhe qytetarie ndaj banorëve. Prandaj, trajtimi i varrezave si “pasuri pa zot”, siç ka ndodhur për vite me radhë, është i papranueshëm dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme institucionale.

Me reformën territoriale të vitit 2015, Bashkisë Durrës iu bashkuan 5 ish-komuna, sot të organizuara si njësi administrative. Me VKM nr. 510/2015, inventari dhe kontabiliteti i ish-komunave i kaloi Bashkisë Durrës, duke bërë që përgjegjësia për administrimin e pasurive publike (përfshirë varrezat) të jetë e bashkisë, jo e njësive administrative.

Aktualisht, administrimi i varrezave në këto njësi mbështetet kryesisht në kontributet e banorëve të fshatrave, për shkak të mungesës së fondeve të dedikuara. Ky model ka sjellë vështirësi në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, si dhe në ofrimin e një shërbimi të unifikuar funeral për qytetarët.

Me këtë projektvendim, propozohet që administrimi i varrezave dhe shërbimit funeral në njësitë administrative Rrashbull, Manëz, Sukth, Katundi i Ri, dhe Ishëm t'i kalojë Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës.

Ky kalim do të mundësojë:

- standardizimin e shërbimit funeral në të gjithë territorin e bashkisë;
- menaxhim dhe mirëmbajtje të rregullt të varrezave;
- mbulim të shpenzimeve përmes buxhetit të Bashkisë Durrës.

Për këtë qëllim:

Do të ngrihet komisioni i vlerësimit dhe inventarizimit të varrezave publike në njësitë administrative Rrashbull, Katund i Ri, Sukth, Manëz dhe Ishëm.

Komisioni do të verifikojë në terren ekzistencën, kufijtë dhe gjendjen e varrezave;

Komisioni do të të përgatisë aktin e vlerësimit dhe procesverbalin e inventarizimit për secilën njësi administrative;

Komisioni do të të përcaktojë vlerën kontabël të pasurive, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës;

Komisioni do të të përgatisë dokumentacionin për futjen në inventarin themeltar të bashkisë.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Pronave dhe Njësitë Administrative do të dorëzojnë zyrtarisht varrezat në administrim tek Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës e cila do të marrë në dorëzim dhe do të kryejë administrimin praktik të tyre;

Drejtoria e Buxhetit do të planifikojë fondet e nevojshme për shpenzimet e mirëmbajtjes dhe administrimit të varrezave.

Gjendja aktuale

Varrezat e njësisë administrative Rrashbull, Sukth, Katundi i Ri, Manëz dhe Ishëm, aktualisht nuk administrohen në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar. Për vite me radhë, këto hapësira kanë qenë nën menaxhim të dobët, shpesh pa kujdesin e duhur institucional dhe pa përgjegjësi të qartë ligjore. Nuk ka pasur një njësi të ngarkuar posaçërisht për mirëmbajtjen; mungojnë evidencat e plota të parcelave, inventarit dhe kufijve; shërbimet janë ofruar pjesërisht dhe jo gjithmonë në përputhje me standardet; në perceptimin e komunitetit, varrezat shpesh janë trajtuar “si mall pa zot”, duke sjellë pakënaqësi dhe mungesë besimi të bashkia.

Nevoja për ndërhyrje

Varrezat janë pasuri publike me rëndësi të veçantë sociale, shpirtërore dhe etike për çdo komunitet. Administrimi i tyre kërkon standarde të larta transparence, përgjegjësie dhe përkujdesjeje, pasi prekin drejtpërdrejt ndjeshmërinë e qytetarëve. Kalimi i administrimit tek një strukturë e specializuar si Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës të varrezave dhe shërbimit funeral siguron:

- Evidentim të qartë të pasurisë në regjistrin e pronave të bashkisë;
- pasqyrim financiar dhe kontabël sipas ligjit, duke i dhënë pronës vlerën reale;
- shërbim të standardizuar, të barabartë dhe transparent për çdo qytetar;
- mirëmbajtje të rregullt të infrastrukturës së varrezave, duke shmangur neglizhencën aktuale;
- përfshirje të varrezave në planin e përgjithshëm të gjelbërimit dhe estetikës urbane.

Risitë që sjell ky administrim

- Krijimi i një përgjegjësie të qartë institucionale: Qytetarët do ta dinë qartë se kush është institucioni përgjegjës për shërbimin.
- Regjistrim dhe dokumentim i plotë: Çdo parcelë, objekt dhe sipërfaqe do të evidentohet, duke shmangur keqpërdorimet dhe pasiguritë.

- shërbim me standarde: Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale ka personel të specializuar dhe
kshperiençë në administrimin e hapësirave publike dhe varrezave.
- Përmirësim i imazhit të bashkisë: Duke treguar kujdes dhe respekt për varrezat, bashkia fiton besim më të madh nga komuniteti.
 - Menaxhim financiar i saktë: Përmes pasqyrimit në kontabilitet, varrezat do të kenë vlerë të regjistruar, duke kontribuar në transparencën buxhetore dhe përgjegjësinë financiare.

Baza ligjore

Ky projektvendim mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ku Neni 23 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" përcakton se: "...Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: "... Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit....".
- Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- VKM nr. 510, datë 10.6.2015, "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

Dokumentet bashkëlidhur

- kopje e VKM-së përkatëse;
- formularët e inventarizimit të pasurisë.


Përfundim

Kalimi i varrezave në administrimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës nuk është thjesht një veprim teknik, por një akt i domosdoshëm për të kthyer dinjitetin e kësaj pasurie publike, për të garantuar shërbim më cilësor për qytetarët dhe për të shmangur trajtimin e tyre si pasuri pa zot.

Ky projektvendim nuk sjell shpenzime shtesë për buxhetin e bashkisë, por vetëm rrit efektivitetin dhe transparencën e administrimit.


DREJTORIA LIGJORE

Alncida Rroshi



DREJTORIA SHËRBIMEVE

Ardian Iljazaj



NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Katundi I Ri	Sukth-Erzen	179			
2	Katundi I Ri	Sukth-Erzen	136			
3	Katundi I Ri	Katundi i Ri	117			
4	Katundi I Ri	Jubë	96			
5	Katundi I Ri	Qerret	87			

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Sukth	Sukth	56	3542		
2	Sukth	Hamallaj		1925		
3	Sukth	Kullë		2321		
4	Sukth	Perlat	10, 11, 26	2321		
5	Sukth	Vadardhë		3690		
6	Sukth	Rrushkull		3241		
7	Sukth	Hidrovor		1925		

NR.	Njësia Administrative	Fshati	Nr. pasurisë	ZK	Sipërfaqia	Nr. varrezave
1	Manëz	Manëz	66/22, 67	2590		
2	Manëz	Fshat Manëz	237/6, 244	2590		
3	Manëz	Armath	75, 78/2	1038		
4	Manëz	Borç	8	1243		
5	Manëz	Hamallaj				
6	Manëz	Kameras	75	2065		
7	Manëz	Shkallë	38	3383		
8	Manëz	Varrezat e katolikëve Shkallë	82/16	3383		
9	Manëz	Radë	61	3137		